



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/157

Datë: 22.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 nëntor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për qasje në informata për shpenzimin ekonomik të karburanteve dhe emisionin e CO₂ të automjeteve të reja personale.
2. Obligohen Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/157

Datë: 22.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 nëntor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes për hua dhe financim nëpërmjet KfW Frankfurt Am Main, Republikës së Kosovës dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut KOSST, për përmirësimin e rrjetit të Transmisionit.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/157

Datë: 22.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 nëntor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për zbatimin e mekanizmave fleksibil për zhvillim të pastër.
2. Obligohen Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/157

Datë: 22.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 nëntor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia e Evropës Juglindore 2020.
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Institucionet tjera kompetente për zbatimin e Strategjisë nga pika1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/157

Datë: 22.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 nëntor 2013, mori:

V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R

1. Aprovohen shpronësimet shtesë me interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës Vërmicë-Merdare, Sektori 7.3 dhe Rugës N9 Prishtinë-Pejë, Zonat Kadastrale, Krushevc, Komuna Obiliq, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, Komuna Fushë Kosovë, Uglar, Komuna Graçanicë dhe zona kadastrale Prishtinë, Komuna e Prishtinës, sipas tabelave bashkangjitur këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat e bashkangjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka

një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij vendimi.

6. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguaj plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
7. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/157

Datë: 22.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 nëntor 2013, mori:

V E N D I M - P R E L I M I N A R

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i rrjetit shpërndarës unazor të transmetuesve dhe infrastrukturës përcjellëse në 22 lokacione për nevoja të institucioneve shtetërore të sigurisë në territorin e Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftoj pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas aprovimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit/MMPH, Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/157

Datë: 22.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 nëntor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Programi Kombëtar për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave për Personat e Shurdhër në Republikën e Kosovës për vitin 2013-2016.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe Institucionet tjera kompetente për zbatimin e Programit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit do të koordinojë, monitoroj dhe raportojë për procesin e zbatimit e programit nga pika 1. e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/157

Datë: 22.11.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 20 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 nëntor 2013, mori:

V E N D I M

1. Z. Dritan Gjonbalaj, riemërohet Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.
2. Mandati i të riemëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë pesë (5) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohen institucionet kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- të riemëruarit
- Arkivit të Qeverisë